



**Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve
Sektori i Profesioneve dhe Kualifikimeve Profesionale**

STANDARDI I KUALIFIKIMIT PROFESIONAL

“TELEKOMUNIKACION”

Niveli IV në KSHK¹, referuar nivelit IV të KEK²

E7-IV-20

Tiranë, 2020

¹ Korniza Shqiptare e Kualifikimeve

² Korniza Evropiane e Kualifikimeve

Emërtimi i kualifikimit	“Telekomunikacion”			Kodi E7-IV-20
Kohëzgjatja	1900-2100 orë	Niveli	IV në KSHK, referuar nivelit IV të KEK	
Qëllimi:	<p>Qëllimi i kualifikimit profesional profili “Telekomunikacion” niveli IV në KSHK, referuar nivelit IV të KEK, është të përgatisë teknik të mesëm për kryerjen e implementimit, mirëmbajtjes dhe operimit të sistemeve të telekomunikacionit, për krijimin e një biznesi privat, si dhe të zhvillojë personalitetin e individit për të jetuar në përshtatje me botën që i rrethon</p>			
Kriteret e përgjithshme të pranimit:	<p>Në institucionet e arsimit profesional që ofrojnë kualifikim profesional “Telekomunikacion” të nivelit IV në KSHK, referuar nivelit IV të KEK, kanë të drejtë të regjistrohen të gjithë individët që:</p> <ul style="list-style-type: none"> - kanë mbaruar dy vitet e para të shkollës së mesme në “Elektroteknikë”, niveli II në KSHK, referuar nivelit II të KEK,; - janë në kushte shëndetësore që të përballojnë kërkesat e këtij niveli të arsimit profesional. 			
Mundësitë e kualifikimit të mëtijshëm dhe të punësimit:	<p>Përfundimi me sukses i kualifikimit profesional “Telekomunikacion” niveli IV në KSHK, referuar nivelit IV të KEK, e pajis individin me Certifikatën Profesionale dhe Supplementin përkatës të teknikut të mesëm, në këtë fushë. Ky kualifikim i jep mundësi individit t'i drejtohet tregut të punës për punësim në ndërmarrje të shërbimeve të telekomunikacionit, si dhe në veprimtari të tjera që ushtrohen në këtë drejtim. Gjithashtu, individi mund të vetëpunësohet në kuadrin e një biznesi individual në fushën telekomunikacionit.</p> <p>Me përfundimin e kualifikimit profesional “Telekomunikacion” niveli IV-të në KSHK, referuar nivelit IV të KEK, individi ka mundësi për të fituar të drejtën e Diplomës së “Maturës Shtetërore Profesionale”, me mundësi për vazhdimin e studimeve pas të mesme dhe universitare.</p>			
Data e validimit	<i>(kur të miratohet)</i>			
Data e miratimit				
Variantet e mëparëshme	K-II-01-14			

STRUKTURA E KUALIFIKIMIT

Rezultatet e të nxënit në:

NJOHURI

Individi duhet të dijë:

Menaxhimi dhe organizimi

- Të përshkruajë sektorin e telekomunikacionit, strukturën ekonomike dhe tendencat e zhvillimit të këtij sektori;
- Të shpjegojë organizimin në mënyrë ergonomike të vendit të punës;
- Të shpjegojë rregullat e komunikimit hierarkik;
- Të përshkruajë hapat e eskalimit (përshkallëzimit) të proceseve të punës për zgjidhjen e problemeve/realizimin e detyrave;
- Të përshkruajë teknikat e negocimit, menaxhimit e mosmarrëveshjeve dhe arritjes së dakordësisë mes palëve;
- Të dallojë materialet e nevojshme për zbatimin e një projekti teknik;
- Të dallojë mjetet e nevojshme për zbatimin e një projekti teknik;
- Të shpjegojë praktikatat e burimeve njerëzore;
- Të përshkruajë teknikat e vlerësimit të mjedisit të punës sipas projektit teknik;
- Të përshkruajë mënyrën e llogaritjeve të tërësisë së materialeve, mjeteve të punës dhe kohës së punës;
- Të përshkruajë përgatitjen e një preventivi sipas projektit teknik;
- Të identifikojë hapat për mbikëqyrjen e ecurisë së nja projekti sipas afatit në kohë dhe për ruajtjen e cilësisë;
- Të përshkruajë elementët e llogaritjes së kostos dhe çmimit të një shërbimi;
- Të përshkruajë teknikat e marketingut;

Dokumentacioni teknik

- Të interpretojë një projekt teknik;
- Të dallojë elementët përbërës të dosjes së klientit;
- Të argumentojë rëndësinë e leximit të manualit teknik;
- Të shpjegojë rëndësinë e planifikimit sipas formateve të caktuara;
- Të dallojë llojet e dokumentacioneve, formulareve etj.;
- Të përshkruajë mënyrën e përpilimit të një urdhri pune;
- Të përshkruajë format dhe mënyrat e ruajtjes së dokumentacioneve;
- Të përshkruajë mënyrën e përgatitjes së një oferte ekonomike;
- Të listojë llojet e faturave dhe mënyrën e plotësimit të tyre;
- Të përshkruajë llojet e raportimeve teknike dhe jo teknike;

Legjislacioni dhe standardet

- Të shpjegojë legjislacionin e fushës së telekomunikacionit që lidhet me instalimet e rrjetave të telekomunikacionit në godina tregtare, ambiente publike, rrugë etj.;
- Të përshkruajë kërkesat rregullatore për lejet, licencat, standardet apo kodet e praktikave që aplikohen për instalime, mirëmbajtje dhe riparime në rrjete telekomunikacioni;
- Të shpjegojë legjislacionin shqiptar të punës, të drejtat dhe detyrimet e punëdhënësit dhe të punëmarrësit;
- Të shpjegojë legjislacionin në fuqi të tatim taksave;
- Të shpjegojë legjislacionin në fuqi për shëndetin dhe sigurinë në punë;
- Të shpjegojë legjislacionin në fuqi për mbrojtjen nga zjarri dhe evakuimin gjatë emergjencave;
- Të shpjegojë legjislacionin në fuqi për sigurimin teknik në punë;
- Të shpjegojë pjesët e standardit IEC që i përkasin teknologjisë elektrike dhe elektronike;
- Të shpjegojë pjesët e standardit ISO/IEC që i përkasin teknologjisë elektrike dhe elektronike, kabllimeve etj.;
- Të shpjegojë standardin TIA/EIA (specifikisht TIA/EIA-568) për kabllimet dhe sistemet e kabllimeve të telekomunikacionit;
- Të listojë organizatat që përkufizojnë standardet e fushës elektrike, elektronike dhe telekomunikacionit si ISO, IEEE, ANSI etj.;
- Të përshkruajë standardet ndërkombëtare të sigurisë dhe shëndetit në punë ISO 45001, AS/NZS 4801:2001, ANSI/ASSP Z10.0-2019;

Rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit

- Të përshkruajë rregullat e sigurimit teknik në punë dhe të mbrojtjes së mjedisit;
- Të përshkruajë teknikat e analizimit dhe menaxhimit të rreziqeve në mjedisin e punës;
- Të vlerësojë menaxhimin e sigurisë ndaj rreziqeve të burimeve të rrymës elektrike, përfshirë parimet e vlerësimit të rrezikut, procedurat e raportimit, masat e kontrollit për të eliminuar ose minimizuar rreziqet elektrike;
- Të analizojë praktikatat e përgjithshme të sigurisë në vendin e punës, përfshirë sjelljen e punonjësit, praktikatat e mira të mbajtjes së ambientit të punës, praktikatat e sigurisë në lidhje me punën në lartësi, pajisjet e mbrojtjes personale etj.;
- Të përshkruajë rreziqe nga zjarri duke përfshirë efektet e tyre të dëmshme, dukuritë tipike dhe përbërësit e nevojshëm;
- Të përshkruajë rregullat e sigurisë dhe evakuimit në raste zjarri, tërmeti, fatkeqësi natyrore etj.;
- Të përshkruajë rregullat e shëndetit dhe sigurisë në punë, përfshirë fushëveprimin, mbulimin dhe objektin;
- Të vlerësojë rreziqet nga zhurmat në mjedisin e punës;
- Të interpretojë sinjalistikën e sigurisë dhe shëndetit në punë;
- Të analizojë rreziqet kryesore të ndotjes së ambientit nga ndikimi i fushave magnetike

dhe elektrostatische dhe masat përkatëse për eliminimin e tyre;

- Të analizojë rreziqet kryesore nga lëndët toksike, radioaktive dhe masat përkatëse për eliminimin e tyre;
- Të shpjegojë rëndësinë e zhvillimit të qëndrueshëm të mjedisit;
- Të shpjegojë rëndësinë e mbajtjes pastër të mjedisit të punës;

BAZAT E TELEKOMUNIKACIONIT

a. Rrjetat Kompjuterike

- Të shpjegojë pjesët përbërëse të rrjetit të telekomunikacionit (paisjet, aplikimet, rrjetat);
- Të dallojë teknologjitë e rrjetave (me dhe pa fije);
- Të dallojë rrjetat personale PAN (Personal Area Network), rrjetat lokale LAN (Local Area Network), rrjetat CAN (Campus Area Network), rrjetat metropol MAN (Metropolitan Area Network), rrjetat e gjera WAN (Wide Area Network)
- Të dallojë topologjitë e rrjetave fizike dhe logjike (Star, Ring, Tree, Peer to Peer, MESH, Hybrid, Client Server etj.) dhe teknologjinë e transmetimit të të dhënave
- Të shpjegojë shtresat e komunikimit të protokolleve - OSI (Open Systems Interconnection);
- Të dallojë protokollat e komunikimit (TCP, IP, UDP, ARP, DHCP, FTP, SNMP, SMTP, Telnet etj.);
- Të përshkruajë adresimin IP – (Internet Protocol), adresat MAC (Media Access Control), portat, ndërfaqet e komunikimit NIC (Network Interface Card) dhe serverat e komunikimit DNS (Domain Name System);
- Të përshkruajë rrjetat pa fije WLAN (Wireless Local Area Network);
- Të përshkruajë rrjetat SAN (Storage Area Network);
- Të përshkruajë rrjetat virtuale VPN (Virtual Private Network)

b. Rrjetat e Telefonisë

- Të dallojë sistemet telefonikë dhe elementët përbërës (Circuit Switched and Packet-Switched Networks), PSTN (Public Switched Telephone Network), PBX (Private Branch eXchange), IP PBX, VoIP, SIP, Gateways etj.);
- Të dallojë teknologjitë e aksesit në rrjet të përdoruesit fundor³ (xDSL (x Digital Subscriber Line), HFC (Hybrid Fiber Coax), FTTC (Fiber To The Curb), FTTH (Fiber To The Home), ADSL (Asymmetric Digital Subscriber Line), ISDN (Integrated Services Digital Network), BRI (Basic Rate Interface), PRI (Primary Rate Interface) etj.);
- Të përshkruajë centralet PBX (Private Branch Exchange), llojet dhe teknologjitë (Analoge, VoIP etj.);

³ Access Network Technology

- Të përshkruajë терминалет (pajisjet fundore) dhe përdorimin e tyre;
- Të shpjegojë koduesit (ADC (Analog to Digital Conversion), DAC (Digital to Analog Conversion) dhe teknologjitë e përdorura;

c. Sistemet Radio – Valor

- Të argumentojë teknologjitë e komunikimit Radio;
- Të dallojë llojet e transmetimit valor dhe frekuencave të komunikimit;
- Të dallojë teknologjitë e gjenerimit të valëve, modulimit, transmetimit, marrësit;
- Të dallojë llojet e rrjetave të komunikimit radio;
- Të dallojë llojet e radiove, elementet, përsëritësat, antenat etj.;
- Të përshkruajë parimet e funksionimit të radarëve dhe elementët përkatës;

d. Komunikimi Wireless Celular

- Të shpjegojë funksionimin e rrjetave GSM (Global System for Mobile Communication) dhe elementët përbërës të tyre (Mobile Station, BSS (Base Station System), SS(Switching System), OSS (Operation and Support System), qelizat, antenat e transmetimit, radio linqet etj.);
- Të dallojë gjeneratat e transmetimit (Voice 1G, Voice 2G, Voice+Data 2,5G, Voice + Data 3G, Voice + HS Data 3,5G, All-IP 4G, Voice +Data Ultra High Speed Data 5G, WiMAX);
- Të përshkruajë elementet funksional shtese (MXE (Message Center), MSN (Mobile Service Node), GMSC (Gateway Mobile Services Switching Center), GIWU – GSM Internetworking Unit)
- Të dallojë shërbimet nëpërmjet rrjetit GSM (DTMF (Dual-Tone Multifrequency, Facsimile) grup III, SMS (Short Message Services), Cell Broadcast, Voice Mail, Fax Mail);
- Të përshkruajë shërbimet shtesë (call forwarding, barring of outgoing calls, advice of charge, call hold, call waiting, multiparty service, calling line identification presentation/restriction, closed user groups);
- Të dallojë transmetimet analoge dhe dixhitale FDMA (Frequency Division Multiple Access), TDMA (Time Division Multiple Access), CDMA (Code Division Multiple Access), ISDN (Integrated Services Digital Network), SMDS (Switched Multi-Megabit Data Services), ATM (Asynchronous Transfer Mode) etj.;

Linjat e transmetimit dhe instalimi

- Të dallojë llojet e linjave të transmetimit (telefonie, internet, FO (Fiober Optoke) sipas përdorimet specifik të kërkuar;
- Të shpjegojë karakteristikat e përhapjes së sinjalit sipas linjë;
- Të argumentojë veçoritë e instalimit dhe/ose montimit të linjave;

- Të interpretojë parametrat fizikë të kabllit (trashësia, shpejtësia e transmetimit etj.);
- Të shpjegojë mënyrën e llogaritjes së parametrave të linjës të cilat janë jo të matshme në mënyrë direkte;
- Të përshkruajë rëndësinë e përgatitjes së vendit të punës për instalimin;
- Të përshkruajë teknikën e bashkimit të kabëllit me konektorët fundorë;
- Të shpjegojë rëndësinë e kryerjes së testimit në sistemin kabllor për funksionalitet pas instalimit;
- Të shpjegojë teknikat e përdorimit të pajisjeve testuese për testimin e linjës pas instalimit;

Transmetimet analoge dhe dixhitale

- Të identifikojë mënyrat e ndryshme të transmetimit të imazheve;
- Të përshkruajë skemat tipike të sistemeve të ndryshme të transmetimit;
- Të përshkruajë karakteristikat e sinjalit në skemat tipike të transmetimit;
- Të lexojë dhe interpretojë sinjalet e një sistemi transmetimi dhe marrjes së imazheve;
- Të listojë llojet e ndryshme të modulimeve dhe demodulimeve;
- Të shpjegojë konceptet e modulimit dhe demodulimit të amplitudës;
- Të shpjegojë konceptet e modulimit dhe demodulimit të frekuencës;
- Të shpjegojë konceptet e modulimit dhe demodulimit të fazës;
- Të shpjegojë sistemet hibride;
- Të shpjegojë teknikat e konvertimit Analog-Digital dhe Digital-Analog;
- Të shpjegojë funksionimin e televizionit me qark të mbyllur (CCTV);
- Të dallojë teknologjitë dhe llojet e transmetimit audio-viziv (kabllor, analog, dixhital, valor, etj.);
- Të përshkruajë parimet e funksionimit të kanaleve televizive;
- Të listojë teknologjitë e së ardhmes në komunikimin radio;

Llojet e matjeve dhe aparatet matëse të telekomunikacionit

- Të përshkruajë mënyrat e matjeve të linjave ethernet, koaxial, telefoni etj.;
- Të dallojë aparatet kryesore të testimit të kabllave ethernet, koaxial dhe telefoni.;
- Të përshkruajë funksionimin e testuesve dhe analizuesve të rrjetit LAN (modele profesionale Fluke apo prodhime të tjera);
- Të dallojë aparatet matëse të linjave elektrike si MEGER, Terrometër etj., si dhe përdorimet e tyre;
- Të përshkruajë pajisje testuese te sistemeve antizjarr dhe sistemeve të alarmit;
- Të përshkruajë pajisjet matëse dhe testuese të zhurmave, temperaturës, lagështirës etj.;
- Të dallojë aparatet matëse dhe testuese të linjave Fiber Optike dhe përdorimet e tyre;
- Të shpjegojë aparatet matëse dhe testuese pajisjeve të transmetimit Audio-Vizive dhe

konvertuesve Analog-Digital;

- Të përshkruajë aparatet matëse dhe testuese të Radio Valëve dhe Frekuencave;
- Të shpjegojë rëndësinë e matjeve dhe krahasimit të tyre me parametrat teknikë të manualeve për funksionimin e rrjetit të komunikimit;

Tik në telekomunikacion

- Të shpjegojë rëndësinë e përdorimit të sistemeve të menaxhimit të klientëve (p.sh. CRM);
- Të shpjegojë rëndësinë e përdorimit të pajisjeve kompjuterike për t të realizuar konfigurime të thjeshta të përdoruesit;
- Të shpjegojë domosdoshmërinë e përdorimit të pajisjeve kompjuterike për të dokumentuar punën pas përfundimit;
- Të shpjegojë rëndësinë e përdorimit të pajisjeve kompjuterike për të qenë i informuar mbi të rejat teknologjike në fushën e studimit;
- Të shpjegojë mënyrën e përdorimit të pajisjeve kompjuterike dhe programeve të dedikuara për të lexuar skedën teknike dhe/ose për ta përditësuar atë pas punës instaluese/riparuese të realizuar;
- Të shpjegojë rëndësinë e përdorimit të sistemet kompjuterike për kryerjen e porosive të materialeve/mjeteve të nevojshme të punës;
- Të argumentojë rëndësinë e përdorimit të kompjuterit për komunikime zyrtare, hierarkike brenda kompanisë dhe për komunikimin me klientin;
- Të shpjegojë rëndësinë e mirëmbajtjes së pajisjeve që ka në përdorim për të qenë të përditësuar nga ana software-ike;
- Të shpjegojë përdorimin e aplikacioneve/programeve të dedikuara për llogaritjen e parametrave jo të matshëm në mënyrë direkte;
- Të shpjegojë përdorimin e programeve të dedikuara software-ike për llogaritjen/leximin e modeleve të rrezatimit të një antene (HFSS..);
- Të shpjegojë rëndësinë e përdorimit të TIK për kryerjen e diagnostikimeve në pajisjet e ndërmjetme të një rrjeti;
- Të përshkruajë mënyrën e përdorimit të ndërfaqeve dhe protokolleve (si comandline, telnet, ping, IP config, FTP) për diagnostikime dhe/ose konfigurime të thjeshta të pajisjeve të rrjetit;
- Të argumentojë përdorimin e pajisjeve kompjuterike për kërkime në internet për zgjidhjen e mundshme të ndonjë problemi teknik;
- Të argumentojë përdorimin e kompjuterave me bazë Windows OS për të organizuar punën dhe për të hartuar raporte;

Diagnostikimi

- Të interpretojë dokumentacionin teknik të rrjetit të telekomunikacionit;

- Të shpjegojë procedurat e diagnostikimit të shërbimeve dhe përdorimet e tyre;
- Të listojë pajisjet diagnostikuese;
- Të listojë programet diagnostikuese;
- Të shpjegojë përdorimin e pajisjeve diagnostikuese;
- Të shpjegojë mirëmbajtjen dhe kalibrimin e pajisjeve diagnostikuese;
- Të shpjegojë përdorimin e programeve diagnostikuese;
- Të listojë defektet kryesore në telekomunikacion, shkaqet dhe pasojat e tyre;
- Të shpjegojë mënyrën e lokalizimit të defekteve në rrjet, shkaqet dhe pasojat e tyre;
- Të parashikojë diagnostikimin në rrjet dhe elementet e tij duke mos afektuar pajisjet dhe shërbimet funksionale (SH);

Shërbime mirëmbajtje dhe riparime të rrjetit të telekomunikacionit

- Të shpjegojë rëndësinë e hartimit dhe zbatimit të grafikut të mirëmbajtjes;
- Të shpjegojë një grafik mirëmbajtjeje dhe elementët e tij;
- Të shpjegojë mënyrën dhe mjetet e testimit për cilësinë e linjës radio sipas grafikut të mirëmbajtjes;
- Të shpjegojë mënyrën dhe mjetet e testimit për cilësinë e linjës kabllore;
- Të shpjegojë mënyrën dhe mjetet e testimit për cilësinë e linjës së fibrës;
- Të shpjegojë mënyrën dhe mjetet e testimit për elementët e rrjetit;
- Të shpjegojë mënyrën dhe mjetet e testimit për pajisjet e rrjetit;
- Të shpjegojë rëndësinë dhe mënyrën e verifikimit të lidhjeve elektrike;
- Të shpjegojë mënyrën e verifikimit të cilësisë së sinjalit të transmetimit;
- Të shpjegojë rëndësinë e verifikimit të cilësisë së montimit të pajisjeve e rrjetit;
- Të shpjegojë mënyrën e verifikimit të parametrave teknike të pajisjeve aktive;
- Të shpjegojë rëndësinë e verifikimit të kushteve mjedisore të funksionimit të rrjetit;
- Të shpjegojë rëndësinë dhe mënyrën e verifikimit të lidhjeve elektrike;
- Të argumentojë rëndësinë e përditësimit të grafikut të mirëmbajtjes;
- Të argumentojë rëndësinë e raportimit në kohë të problemeve të evidentuara;
- Të shpjegojë domosdoshmërinë e leximit të manualit të shërbimit të pajisjeve para riparimeve në telekomunikacion;
- Të interpretojë skema dhe projektet përkatëse para procesit të riparimeve në telekomunikacion;
- Të shpjegojë mënyrën dhe lejet e nevojshme për shkëputjen e lidhjeve elektrike para procesit të riparimit;
- Të shpjegojë nevojën e verifikimit të parametrave teknik të elementëve të rrjetit që do të zëvendësohet;
- Të shpjegojë teknikat e riparimit të kabllit FO;
- Të shpjegojë teknikat e riparimit të kabujve ethernet, telefonik;
- Të shpjegojë teknikat e riparimit të kabujve koaksial;

- Të shpjegojë teknikat e bashkimit të kabujve;
- Të përshkruajë mënyrën e përdorimit të pajisjeve bashkuese, riparuese;
- Të shpjegojë mënyrat e riparimit të pajisjeve të radio transmetuese;
- Të përshkruajë radhën e punës për zëvendësimin e pajisjet e defektuara;
- Të përshkruajë procesin e çmontimit dhe montimit të pajisjeve të defektuara;

Sipermarrja dhe edukim për karriere

- Të përshkruajë konceptet bazë të sipërmarrjes;
- Të dallojë llojet e sipërmarrjeve;
- Të përshkruajë strukturat, organizimin dhe funksionimin e një sipërmarrje të vogël;
- Të argumentojë detyrimet dhe të drejtat ndaj institucioneve ligjore (QKB- Qendra Kombëtare e Biznesit, DPT-Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Bashki);
- Të përshkruajë shërbimet inovative online e-albania dhe e-tax;
- Të dallojë nocionet financiare, kosto, TVSH-tatim i vlerës së shtuar, takse doganore, fitim bruto, fitim neto, tatim fitimi, dividend, kontributet shëndetësore dhe sociale, kredi, financim, konkurrencë, shpenzim, bilanc, etj.;
- Të përshkruajë rëndësinë e përditësimit të njohurive teknike përmes edukimit të vazhdueshëm, workshop-eve, revistave shkencore, komunikimit me koleg, etj.;
- Të argumentojë rëndësinë e bashkëpunimit me pjesën tjetër të stafit në departamentin e telekomunikacionit me qëllim ofrimin e një shërbimi sa më të mirë klientit;
- Të argumentojë rëndësinë e aftësisë për marrjen e iniciativave;
- Të shpjegojë aftësinë për zgjidhjen e problemeve teknike në mënyrë të pavarur ose si pjesë e një grupi kur kjo kërkohet;
- Të argumentojë aftësinë për të realizuar disa detyra në të njëjtën kohë;
- Të përshkruajë rëndësinë e prioritarizimit në kryerjen e punëve në rastin e detyrave të shumfishta në një mjedis potencialisht stresues;
- Të argumentojë rëndësinë e zhvillimit të njohurive dhe aftësive për t'u përshtatur me kultura dhe mjedise të ndryshme shoqërore;

SHPREHI PROFESIONALE

Individi duhet të jetë i aftë:

Menaxhim dhe organizim

- Të kryejë organizimin në mënyrë ergonomike të vendit të punës;
- Të zbatojë rregullat e komunikimit hierarkik;
- Të zbatojë hapat e eskalimit (përshkallëzimit) të proceseve të punës për zgjidhjen e problemeve/realizimin e detyrave;
- Të zbatojë teknikat e negocimit, menaxhimin e mosmarrëveshjeve dhe arritjes së

dakordësisë mes palëve;

- Të përzgjedhë materialet e nevojshme për zbatimin e një projekti teknik;
- Të përzgjedhë mjetet e nevojshme të punës për zbatimin e një projekti teknik;
- Të zbatojë praktikatat e menaxhimit burimeve njerëzore;
- Të zbatojë teknikatat e vlerësimit të mjedisit të punës sipas projektit teknik;
- Të llogarisë tërësinë e materialeve, mjeteve të punës dhe kohës së punës;
- Të përgatisë një preventiv sipas projektit teknik;
- Të zbatojë hapat për mbikëqyrjen e ecurisë së një projekti sipas afatit në kohë dhe për ruajtjen e cilësisë;
- Të llogarisë koston dhe çmimin e një shërbimi;
- Të demonstrojë teknikatat e marketingut;
- Të zbatojë kërkesat rregullatore për lejet, licencat, standardet apo kodet e praktikave që aplikohen për instalime, mirëmbajtje dhe riparime në rrjete telekomunikacioni;
- Të zbatojë legjisllacionin në fuqi për shëndetin dhe sigurinë në punë;
- Të zbatojë legjisllacionin shqiptar të punës, të drejtat dhe detyrimet e punëmarrësit;

Instalimi

- Të verifikojë kushtet mjedisore të instalimit;
- Të përgatisë vendin e punës për instalimin e linjave të rrjetit të telekomunikacionit;
- Të përgatisë kabllin e fibrës optike për instalim sipas protokollit të caktuar;
- Të përgatisë kabujt telefonik, ethernet dhe koaxial për instalim;
- Të përzgjedhë materialet dhe mjetet e nevojshme për instalimin e linjës me fibër optike;
- Të përzgjedhë materialet dhe mjetet e nevojshme për instalimin e kabujve telefonik/ethernet dhe koaxial;
- Të lexojë skedën teknike të instalimit dhe të konfiguracionit të paisjeve;
- Të llogarisë burimet e energjisë para instalimit të pajisjeve;
- Të bashkojë linjën kabllore me elementët fundor;
- Të kryejë instalimet e pajisjeve dhe materialeve sipas projektit në përputhje me standardet ISO/IEC, TIA/EIA etj.;
- Të llogarisë parametrat jo të matshëm në mënyrë direkte;
- Të kontrollojë parametrat e sinjalit në linjë pas instalimit me pajisjet e duhura;
- Të mbajë pastër mjedisin e punës;

Diagnostikimi

- Të përzgjedhë dhe analizojë informacionin e duhur për të diagnostikuar problemet në telekomunikacion;
- Të konsultojë historikun e diagnozave të hasura në telekomunikacion;
- Të përcaktojë radhën e punës për të realizuar diagnostikimin;
- Të përzgjedhë pajisjet e duhura për të kryer diagnostikimin;
- Të përdorë pajisjet matëse për të diagnostikuar problemet në telekomunikacion;

- Të lexojë manualët e përdorimit të pajisjeve për të realizuar diagnostikimin;
- Të testojë nivelin e zhurmave dhe humbjeve të sinjalit në rrjetin LAN, telefoni dhe koaksial;
- Të testojë nivelin e humbjeve të sinjalit në rrjetin Fiber Optike;
- Të testojë nivelin e humbjes së sinjalit Valor në transmetimin Valor;
- Të testojë cilësinë e sinjalit dhe interferencën e kanaleve/frekuencave të komunikimit Wireless dhe Valor;
- Të testojë cilësinë e sinjalit dhe interferencën e valëve të transmetimit televizive;
- Të kontrollojë konfigurimet e komunikimit IP në telekomunikacion;
- Të analizojë problemet e diagnostikuara dhe efektet që mund të shkaktojë në rrjet;
- Të konsultojë përshkallëzimin hierarkik të diagnostikimit;

Shërbime mirëmbajtje dhe riparime

- Të hartojë grafikun të mirëmbajtjes së rrjetit;
- Të zbatojë protokollin e mirëmbajtjes së rrjetit;
- Të testojë cilësinë e linjës radio sipas grafikut të mirëmbajtjes;
- Të testojë cilësinë e linjës kabllore sipas grafikut të mirëmbajtjes;
- Të testojë cilësinë e linjës së fibrës optike sipas grafikut të mirëmbajtjes;
- Të testojë pajisjet e rrjetit sipas grafikut të mirëmbajtjes;
- Të verifikojë saktësinë e lidhjeve elektrike;
- Të verifikojë cilësinë e montimit të pajisjeve të rrjetit;
- Të verifikojë kushtet mjedisore të funksionimit të rrjetit;
- Të përditësojë grafikun e mirëmbajtjes;
- Të raportojë në kohë problemet e evidentuara;
- Të zbatojë manualin e shërbimit të pajisjeve para riparimeve në telekomunikacion;
- Të analizojë skema dhe projektet përkatëse para procesit të riparimeve në telekomunikacion;
- Të kryejë shkëputjen e lidhjeve elektrike para procesit të riparimit;
- Të kryejë verifikimin e parametrave teknik të elementëve të rrjetit që do të zëvendësohen;
- Të kryejë riparimin e kabllit FO;
- Të kryejë riparimin e kabujve ethernet, telefonik;
- Të kryejë riparimin e kabujve koaksial;
- Të zëvendësojë elementet lidhës të kabllimit;
- Të ripozicionojë pajisjet radio transmetuese;
- Të kryejë riparime të thjeshta të pajisjeve radio-transmetuese;
- Të kryejë çmontimin dhe montimin e pajisjeve të defektuara;
- Të krahasojë matjet me parametrat teknikë të manualeve për funksionimin e rrjetit të komunikimit;

Dokumentimi

- Të hartojë dhe përditësojë dosjen e klientit, sipas planimetrive, rrugëve të kalimit, etiketimit, sinjalistikës dhe elementeve teknik të telekomunikacionit si në fazën përgatitore, gjatë zbatimit, dhe në fazën e dorëzimit përfundimtar të projektit;
- Të hartojë një urdhër pune bazuar në proceset e punës sipas projektit;
- Të hartojë manuale me instruksione të thjeshta të përdorimit të rrjetit;
- Të përpilojë një listë kontrolli për të vlerësuar ecurinë e punës;
- Të përpilojë raporte për zbatimin dhe mbylljen e urdhrat të punës;
- Të përditësojë bazën e të dhënave në lidhje me performancën e grupit të punës sipas detyrave dhe zbatimit të tyre;
- Të përditësojë dokumentacionet teknike në formate të ndryshme (fizike ose elektronike) sipas afateve dhe procedurave të brendshme të kompanisë;
- Të përditësojë procedurat të brendshme të kompanisë që lidhen me zbatimin dhe mbarëvajtjen e rregulloreve teknik të telekomunikacionit;
- Të përditësojë dokumentacionin teknike që lidhet me trajnimin e stafit teknik të telekomunikacionit.

Tik në telekomunikacion

- Të përdorë pajisjet kompjuterike për të realizuar konfigurime të thjeshta të pajisjeve të telekomunikacionit si modeme, access point, dekoder, switch, router etj.;
- Të përdorë programet microsoft office, AutoCAD, Visio, MATLAB etj.;
- Të mirëmbajë pajisjet dhe programet (p.sh. kompjuter, analizator rrjeti) për të qenë të përditësuar nga ana software-ike;
- Të përdorë aplikacione/ programe të dedikuara për llogaritjen e parametrave jo të matshëm në mënyrë direkte;
- Të përdorë programe të dedikuara software-ike për llogaritjen/leximin e modeleve të rrezatimit të një antene(HFSS);
- Të përdorë ndërfaqe dhe protokolle (si comandline, telnet, ping, IP config, FTP, SSH) për diagnostikime dhe/ose konfigurime të thjeshta të pajisjeve të rrjetit;
- Të përdorë motorët e kërkimit në internet për zgjidhjen e mundshme të ndonjë problemi teknik;
- Të përdorë kompjuterat me bazë sistemi operativ Windows OS, Linux, Mac;

Rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit

- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik gjatë instalimit të pajisjeve dhe sistemeve të telekomunikacionit;
- Të zbatojë rregullat e shëndetit dhe sigurisë në punë;
- Të përdorë mjetet e duhura për sigurinë dhe shëndetin në punë;
- Të zbatojë praktikatat e mira për menaxhimin dhe eliminimin e rreziqeve në mjedisin e punës;

- Të përdorë masat e sigurisë ndaj rreziqeve të burimeve të rrymës elektrike;
- Të zbatojë rregullat e mbrojtëse nga zjarri;
- Të zbatojë procedurat e kontrollit dhe të mirëmbajtjes së pajisjeve anti zjarr;
- Të zbatojë rregullat dhe përdorë mjetet e duhura për sigurinë nga punë në lartësi, rrugë, etj.;
- Të përdorë rregullat e sigurisë dhe evakuimit në raste zjarri, tërmeti, fatkeqësi natyrore etj.;
- Të zbatojë rregullat mbrojtëse nga zhurmat në mjedisin e punës;
- Të zbatojë sinjalistikën e sigurisë dhe shëndetit në punë;
- Të përdorë rregullat mbrojtëse nga fushat magnetike dhe elektrostatike;
- Të zbatojë rregullat e sigurisë nga lëndët toksike, radioaktive;
- Të zbatojë rregullat e mbajtjes pastër të mjedisit të punës;

Sipërmarrje dhe edukim për karrierën

- Të përdorë teknologjive e informacionit dhe të komunikimit në një sipërmarrje biznesi;
- Të shfrytëzojë format e sipërmarrjes për karrierë personale, mundësitë dhe përfitimet në komunitet;
- Të hartojë një plan efektiv biznesi sipas profilit përkatës;
- Të përdorë dokumentet financiare në kompani për të bërë analiza pune;
- Të menaxhojë aktivitetin e kompanisë duke respektuar buxhetin e përcaktuar;
- Të përdorë metoda dhe teknika të ndryshme të zbatimit të një projekti;
- Të përdorë aftësitë për planifikim dhe menaxhim projekti në situata të ndryshme;
- Të përdorë Analiza SWOT etj. për të menaxhuar dhe zbatuar një projekt në situata të ndryshme;
- Të analizojë të dhënat për të marrë vendimet e duhura në kontekste të ndryshme;
- Të identifikojë dhe të zgjidhë probleme në mënyrë krijuese;
- Të negociojë ide me të tjerët në mënyrë efektive;
- Të demonstrojë aftësi për të njohur dhe vlerësuar risqet;
- Të demonstrojë aftësi për të planifikuar, kontrolluar dhe vepruar me qëllim për t'u vetë-përmirësuar;
- Të vlerësojë potencialin personal (aftësitë personale, sociale dhe aftësitë për biznes, njohuritë e mëparshme) për të shfrytëzuar avantazhin konkurrues;
- Të demonstrojë aftësi udhëheqëse në situata të ndryshme;
- Të demonstrojë aftësi për të aplikuar parimet e ekonomisë së lirë të tregut në situata të ndryshme;
- Të demonstrojë aftësi për të motivuar dhe inkurajuar të tjerët në arritjen e synimeve;
- Të sigurojë burimet e duhura dhe të marrë përgjegjësinë për t'u kujdesuar për to;
- Të menaxhojë stafin dhe mundësinë e zhvillimit të karrierës profesionale të tyre;
- Të realizojë procesin e vetvlerësimit të kompanisë, për analiza pune dhe rezultate;

KOMPETENCA TE PERGJITHSHME

Individi duhet të jetë i aftë:

- Të komunikojë në mënyrë korrekte me shkrim e me gojë për të shprehur mendimet e ndjenjat e tij dhe për të argumentuar opinionet për çështje të ndryshme.
- Të përdorë burime dhe teknika të ndryshme të mbledhjes dhe të shfrytëzimit të informacioneve të nevojshme për zhvillimin e tij personal dhe profesional.
- Të nxisë potencialin e tij të brendshëm në kërkim të vazhdueshëm për zgjidhje të reja më efektive dhe më eficientë.
- Të angazhohet fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme në kontekstin profesional, personal dhe shoqëror.
- Të respektojë rregullat dhe parimet e një bashkëjetese demokratike në kontekstin e integriteteve lokale, rajonale.
- Të manifestojë guxim dhe aftësi sipërmarrëse për të ardhmen e tij.
- Të tregojë vetëkontroll gjatë ushtrimit të veprimtarive të tij.
- Të organizojë drejt, procesin e të nxënimit të tij dhe të shfaqë gatishmërinë dhe vullnetin për të nxënë gjatë gjithë jetës.
- Të respektojë parimet e punës në grup dhe të bashkëpunojë aktivisht në arritjen e objektivave të pranuar.
- Të vlerësojë dhe vetëvlerësojë nisur nga kritere të drejta si bazë për të përmirësuar dhe çuar më tej arritjet e tij.
-